




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 272/25
Data: 09-04-25

Prishtinë, 22 mars 2024
Kodi i ZRRE-së: V_1924_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenin 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenin 47 dhe Nenin 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullën Nr. 15/2017 për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Dispozitat e Rregullës Nr. 03/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT);
- Dispozitat e Rregullës Nr.05/2017 për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH);
- Njoftimin e ZRRE-së, Nr. 566/23 Azhurnimet Vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për OST/OT, OSSH dhe FSHU, të datës 12.12.2023;
- Vendimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut OST/OT, Nr. V_1922_2024;
- Vendimin për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes – OSSH, Nr. V_1923_2024; dhe
- Aplikacionin e Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU/KESCO SH.A) për të Hyrat e Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal, të dorëzuar me datë 22 janar 2024 në ZRRE;

në seancën e mbajtur më 22 mars 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (në tekstin e mëtejme HLM) për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU) për vitin relevant tarifor 2024.**
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizuesit me Shërbim Universal për vitin 2024 do të jenë 399,617,290 €.**
- III. OBLIGOHET – Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) që të përgatisë dhe dorëzojë në ZRRE për aprovim propozimin e tarifave të rregulluara me pakicë sipas këtij Vendimi.**
- IV. Ky vendim do të zbatohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) duke filluar nga 1 prill 2024.**



ARSYETIM


- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 12 dhjetor 2024 ka iniciuar procesin: Azhurnimet Vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për Operatorët e Rregulluar duke përfshirë edhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU).
- ZRRE sipas njoftimit të saj ka vlerësuar se ky proces i Azhurnimeve Vjetore të të Hyrave dhe Tarifave për vitin relevant tarifor 2024 ka për qëllim për të vendosur të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) të të Licencuarit FSHU, për periudhën 1 prill 2024 deri më 31 mars 2025.
- ZRRE më datë 22 janar 2024 ka pranuar aplikacionin nga Furnizuesi me Shërbim Universal për Të Hyrat e Lejuara Maksimale për vitin 2024.
- Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit për të hyrat e lejuara maksimale, nëpërmjet korrespondencave të vazhdueshme, ZRRE ka kërkuar nga FSHU dhënien e informacionit, përditësimin e të dhënave, argumenteve dhe dokumentacionit justifikues lidhur me të gjitha çështjet e evidentuara në mënyrë që të kemi transparencë për marrjen e një vendimi të drejtë dhe me kosto reflektive të tarifave.
- ZRRE pas vlerësimit fillestar të Aplikacioneve lidhur me të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM/MAR) për të licencuarin KESCO, furnizues me Obligimin e Shërbimit Publik, me të dhënat e realizuara dhe parashikuara të indikatorëve teknik, ekonomik dhe financiar, i licencuari dhe palët tjera të interesit kanë pasur mundësi t'i paraqesin komentet e tyre përmes konsultimit publik për periudhë dy javore.
- ZRRE më datë 6 shkurt 2024 ka publikuar Raportin Konsultativ-Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale FSHU, viti relevant tarifor 2024.
- Raporti konsultativ ka paraqitur propozimet e ZRRE-së për HLM që do të mbulohen nga FSHU gjatë vitit relevant tarifor 2024. Të Hyrat e Lejuara Maksimale të miratuara do të përcaktojnë tarifën me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit Universal, që do të zbatohen nga Furnizuesi me Shërbim Universal për konsumatorët e rregulluar. Raporti është vënë në diskutim publik me synimin që të marrë komentet e palëve të interesit për propozimet e ZRRE-së.
- ZRRE gjatë konsultimit publik ka pranuar komente nga palë të ndryshme të interesit ndaj Raportit Konsultativ lidhur me Përshtatjet Vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU, dhe atë nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) dhe FSHU.
- FSHU ka dorëzuar komentet më datë 21 shkurt 2024, ndaj Raportit Konsultativ për Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU.
- ZRRE i ka trajtuar komentet e FSHU që kanë të bëjnë me kostot e blerjes së energjisë me shumicë për vitin 2024, kostot e lejuara me pakicë, kostot e bartshme, përshtatjet, faktorin korrigjues të të hyrave dhe komponentët tjera të kostove, dhe pas vlerësimit dhe analizimit ka ofruar sqarime dhe të njëjtat i ka përfshirë në raportin përfundimtar për HLM për FSHU.





- ZRRE i ka shqyrtuar dhe analizuar edhe komentet e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Institutit Për Politika Zhvillimore (INDEP), ku pas analizimit dhe vlerësimit ka paraqitur përgjigjet me shkrim të cilat i ka përfshirë në Raportin Përfundimtar.
 - Raporti Përfundimtar i Shqyrtimit të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU, përfshinë edhe të dhënat e përditësuara nga FSHU. ZRRE në vlerësimin përfundimtar ka marrë në konsideratë përditësimet e bëra dhe çështjet e ngritura nga të gjitha palët e interesit në procesin e konsultimit publik.
 - Vlen të theksohet që të Hyrat e Lejuara Maksimale për FSHU do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta Vjetore, sipas Rregullës Nr. 15/2017 për Të Hyrat e FSHU-së, të nxjerr nga ZRRE.
 - FSHU/KESCO propozimet për tarifatat të rregulluara me pakicë duhet ti bëjë në pajtim me Rregullën Nr. 15/2017 për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU).
 - Bordi i ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO,
- KEDS,
- KOSTT dhe
- Arkivit të ZRRE-së.